



## Match-Maker Albania

2<sup>EDITION</sup>

### MATCH-MAKER ALBANIA 2: SHQIPËRIA NË FOKUSIN E INVESTITORËVE

Më 26 mars, Tirana u shndërrua në një forum strategjik investimesh me zhvillimin e Match-Maker Albania 2026, duke mbledhur:

+1200

**PJESËMARRËS**

+500

**INVESTITORE  
NDËRKOMBËTARË**

8

**AGJENCI  
INVESTIMESH**

+400

**TAKIME B2B**

Eventi krijoi një hapësirë ku ide dhe mundësi u kthyen në projekte konkrete, duke forcuar bashkëpunimin ndërkombëtar dhe duke gjeneruar perspektiva reale zhvillimi. Gjatë ditës u prezantuan projekte shtetërore dhe private, duke ofruar transparencë dhe mundësi të qarta për të gjithë aktorët e interesuar. Pjesëmarrja e institucioneve dhe e kompanive globale si World Bank, IFC, Forbes Global Properties, Minor Hotels Group, Enhol Company, Lidl, Catwell dhe të tjera, i dha eventit një dimension ndërkombëtar, duke konfirmuar Shqipërinë si një destinacion serioz për investime strategjike.

MatchMaker Albania 2026 nuk ishte thjesht një event biznesi – ishte një platformë që forcon pozicionin e Shqipërisë në hartën globale të investimeve, duke krijuar hapësira për partneritete afatgjata dhe zhvillim të qëndrueshëm.

## Ceremonia e Hapjes

Në ceremoninë e hapjes morën pjesë përfaqësues të lartë të shtetit dhe institucioneve, të cilët ndanë vizionin e tyre për zhvillimin ekonomik të vendit.

**Znj. Laura Saro**, Drejtoresha Ekzekutive e AIDA-s, theksoi se agjencia vepron si një "one-stop-shop" për investitorët, duke lidhur vizionin e qeverisë me realitetin e biznesit dhe duke mbetur një partner afatgjatë.

**Z. Edi Rama**, Kryeministër i Shqipërisë, u ndal te progresi i vendit dhe rritja e besimit të investitorëve, duke theksuar potencialin në sektorë si turizmi, eksportet dhe ekonomia digjitale, si dhe rolin strategjik të energjisë.

**Znj. Delina Ibrahimaj**, Ministre e Ekonomisë dhe Inovacionit, nënvizoi rëndësinë e eventit në lidhjen e investitorëve me projekte konkrete dhe rritjen e investimeve të huaja.

**Z. Blendi Gonxhja**, Ministër i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sportit, theksoi rolin e turizmit cilësor dhe të qëndrueshëm si një sektor kyç për zhvillimin ekonomik.

**Z. Enea Karakaci**, Ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, evidentoi potencialin e sektorit energjetik dhe progresin e arritur përmes reformave dhe integritimit në tregjet rajonale.



## Zona Future Estate – Match Maker Albania 2

Në kuadër të Match Maker Albania 2, Zona Future Estate u shndërrua në një nga hapësirat më dinamike të eventit, duke bashkuar në një platformë të vetme investitorë, arkitektë dhe zhvillues nga tregjet ndërkombëtare.

Në këtë zonë u prezantuan 20 projekte – 15 private dhe 5 shtetërore – duke reflektuar qartë transformimin urban dhe turistik që po zhvillohet në Shqipëri.

Prania e studiove të njohura arkitekturore si Bofill Taller de Arquitectura (Spanjë), A Is For Architecture (Mbretëria e Bashkuar), Adoras (Spanjë) dhe MAB Architecture Studio (Itali) i dha zonës një dimension të fortë ndërkombëtar, i reflektuar edhe në prezantimet e tyre gjatë aktivitetit.

Interesi i investitorëve ishte konkret dhe i dukshëm. Aura Sanctuaries nga Gjermania prezantoi një projekt me vlerë 7 milionë euro, ndërsa Swissôtel u prezantua për herë të parë në Shqipëri me plane të qarta zhvillimi në tregun vendas, duke dëshmuar hyrjen e markave të rëndësishme ndërkombëtare. Po ashtu, Minor Hotels Group, me mbi 560 hotele në mbarë botën, shprehu interes për zgjerim në Shqipëri, ndërsa Marcus Benussi, Managing Director i Forbes Global Properties, solli një perspektivë të rëndësishme mbi potencialin në rritje të tregut të pasurive të paluajtshme në vend.



Të pranishme ishin edhe institucionet kryesore shtetërore, duke përfshirë Ministrinë e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Agjencinë e Zhvillimit të Territorit dhe Korporatën e Investimeve Shqiptare, duke nënvizuar rëndësinë e bashkëpunimit publik-privat në zhvillimin e projekteve strategjike.

Zona Future Estate konfirmoi edhe një herë se Shqipëria po konsolidohet si një destinacion i besueshëm për investime në turizëm dhe pasuri të paluajtshme, duke krijuar lidhje të drejtpërdrejta mes ideve, kapitalit dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

## Zona Smart Agriculture – Match Maker Albania 2

Zona e Smart Agriculture ishte një pjesë integrale e MatchMaker Albania 2, duke bashkuar institucione, kompani dhe investitorë në një ekosistem të përbashkët bashkëpunimi.

Me pjesëmarrjen e aktorëve ndërkombëtarë si FAO, World Bank dhe UNDP, si dhe institucioneve vendase si Ministria e Bujqësisë dhe AZHBR, zona solli në fokus prioritetet për modernizimin dhe digjitalizimin e sektorit.

Interes të lartë treguan edhe kompanitë ndërkombëtare, ku Lidl spikati me numrin më të madh të takimeve gjatë gjithë eventit, të kombinuara mes takimeve të planifikuara dhe atyre të realizuara në vend. Një tjetër kompani ndërkombëtare, Cetwell, prezantoi modele të avancuara në zhvillimin e serrave me teknologji të avancuar, duke zgjuar interes të konsiderueshëm nga bizneset vendase. Gjithashtu, aktorë si Simest kontribuan në diskutimet mbi mundësitë e investimit.

Në të njëjtën kohë, start-up-et prezantuan zgjidhje inovative në agri-tech, duke reflektuar potencialin e inovacionit në sektorin bujqësor.

Një tjetër moment i rëndësishëm ishte prezantimi i produkteve shqiptare premium, ku mbi 500 vizitorë patën mundësinë të degustojnë produkte si verë, vaj ulliri dhe mjaltë, duke evidentuar cilësinë dhe potencialin e tyre për eksport.



## Zona Digital Horizons – Match Maker Albania 2

Në kuadër të Match Maker Albania, zona Digital Horizons u shndërrua në një qendër të aktivitetit teknologjik dhe inovacionit, ku Shqipëria u shfaq si një destinacion me potencial për investime digjitale dhe bashkëpunime ndërkombëtare.

Gjatë eventit u zhvilluan prezantime të drejtpërdrejta nga institucione, kompani dhe startup-e, ku u diskutua përdorimi i inteligjencës artificiale në shërbimet publike, inovacioni në sektorët tradicionalë dhe transformimi digjital i bizneseve. Startup-et më të suksesshme shqiptare prezantuan zgjidhje konkrete, duke treguar potencial për rritje dhe ndërkombëtarizim. Workshop-et e organizuara u fokusuan te siguria kibernetike dhe gatishmëria e bizneseve për të përqaftuar tranzicionin drejt inteligjencës artificiale. Një moment interaktiv me fireside chat, tregoi qartë mundësitë për bashkëpunim dhe mentorim ndërkombëtar.

Zona tërhoqi gjithashtu interesin e kompanive të huaja, të cilat zhvilluan takime direkte me aktorët shqiptarë. Përfaqësuesit e tyre vinin nga rajoni i Ballkanit, Polonia, Italia, Franca, Çekia, Hungaria, Holanda dhe Emiratet e Bashkuara Arabe dhe shfaqën interes të veçantë për sektorët strategjikë si cybersecurity, AI, R&D, software dhe inovacion teknologjik, duke treguar gatishmërinë për të investuar dhe zgjeruar aktivitetin në Shqipëri.

Në këtë frymë bashkëpunimi u nënshkrua edhe Marrëveshja e Bashkëpunimit midis AIDA dhe 28Digital, një hap konkret që synon të forcojë ekosistemin digjital dhe inovacionin në vend.

Digital Horizons konfirmoi kështu rolin e saj si një platformë ku prezantohen ide, krijohen lidhje dhe hapen mundësi konkrete për partneritete ndërkombëtare, duke vendosur Shqipërinë në hartën e inovacionit rajonal dhe global.



## Zona Power Next – Match Maker Albania 2

Power Next në Match-Maker Albania 2 u zhvillua si platformë strategjike që bashkoi institucione publike, financiare ndërkombëtare, investitorë dhe kompani kryesore të energjisë.

Zona u hap nga Zv/Ministrja Edona Bilali, e cila theksoi potencialin energjetik të Shqipërisë, ndërsa Ergys Verdho prezantoi zhvillimet dhe projektet hekurudhore me ndikim në ekonomi dhe ndërlidhje.

U trajtuan progresi i tranzicionit energjetik dhe roli i European Investment Bank, si dhe u prezantuan investime dhe iniciativa nga kompani si Kiraç Group, Volitalia, Blessed Investment, Devinn (hidrogjeni i gjelbër), Enhol Group, MASDAR dhe X-Wind.

Hapësira "Meet the Government" mundësoi dialog të drejtpërdrejtë mes biznesit dhe institucioneve kyçe (MIE, ERE, OST, APD, AKBN, Hekurudha Shqiptare), ndërsa pjesëmarrja e EBRD, EIB, World Bank dhe KfW rriti mundësitë për financim. Gjatë eventit u zhvilluan takime B2B dhe B2G, të cilat rezultuan me krijimin e kontakteve të reja dhe hapjen e perspektivave për bashkëpunime të qëndrueshme.

Power Next shërbeu si një hapësirë dinamike dhe produktive, që kontribuon drejtpërdrejt në avancimin e projekteve energjetike dhe në pozicionimin e Shqipërisë si një destinacion serioz për investime madhore në sektor.



## Rezultatet e para nga Match Maker Albania 2

Në vijim të Match Maker Albania, takimet B2B po japin rezultatet e para konkrete, duke dëshmuar potencialin real të bashkëpunimeve të krijuara gjatë eventit.

Një nga këto raste suksesi ishte edhe TEDA Tirana, e cila si pjesë e zonës "Digital Horizons" tërhoqi interes nga partnerë ndërkombëtarë. Si rrjedhojë, u nënshkrua një Memorandum Mirëkuptimi midis TEDA Tirana dhe Dhomës Evropiane të Tregtisë në Dubai.

Kjo marrëveshje synon të identifikojë dhe tërheqë biznese të huaja për t'u vendosur në TEDA Tirana, duke përbërë një hap konkret drejt forcimit të investimeve në vend.

Ky është vetëm fillimi i bashkëpunimeve që pritet të konkretizohen në vijim, si rezultat i lidhjeve të krijuara gjatë MatchMaker Albania.



## Shqipëria në Food Expo 2026 : 14-16 Mars 2026 Athinë, Greqi

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) përmbylli me sukses pjesëmarrjen e Shqipërisë në Food Expo 2026, një nga panairët më të rëndësishme ndërkombëtare të industrisë ushqimore, zhvilluar në Athinë.

Gjatë tre ditëve të panairit (14-16 mars 2026), stenda shqiptare në Hall 1 | Stand F20 u kthye në një pikë kyçe për takime profesionale, prezantime produktesh dhe krijim mundësish bashkëpunimi për bizneset shqiptare.

Stenda u vizitua nga Ambasadorja e Shqipërisë në Greqi, znj. Lueta Hajdaraga, e cila vlerësoi organizimin dhe prezantimin dinjitoz të produkteve shqiptare. Ajo përgëzoi kompanitë pjesëmarrëse për cilësinë dhe përkushtimin, duke i inkurajuar të vazhdojnë të konkurrojnë në tregjet ndërkombëtare në nivel evropian.

Në fokus të promovimit ishin produkte tradicionale dhe cilësore shqiptare si kafe, verë, vaj ulliri, turshi dhe komposto, lëngje bio dhe bimë medicinale përfaqësuar nga 6 kompanitë shqiptare pjesëmarrëse:

- Bioe Bess – Produkte bimë medicinale
- Drizzi sh.p.k – Prodhues vaj ulliri
- Enofama Winery – Verëra premium shqiptare
- Dua Caffè – Kafë premium
- Amaral (Home Paradise) – Produkte agro-ushqimore
- Zdrava Group – Produkte ushqimore & shpërndarje

Vizitorë të shumtë ndërkombëtarë – distributorë, blerës dhe sipërmarrës – patën mundësinë të njihen nga afër me diversitetin dhe cilësinë e produkteve "Made in Albania", duke rritur interesin për eksportet shqiptare.

Pjesëmarrja u realizua në bashkëpunim me:

- Swiss Import Promotion Programme (SIPPO)
- Forum S.A. (përmes përfaqësuesit Rumingidea)

Rezultatet kryesore:

- Mbi 200 kontakte biznesi
- 55+ kontakte serioze bashkëpunimi
- Rreth 140,000 € potencial marrëveshesh

Një rol të veçantë pati edhe komuniteti shqiptar në Greqi, i cili vizitoi stendën dhe shprehu mbështetje e krenari për produktet vendase.

Kjo pjesëmarrje konfirmon angazhimin e AIDA-s për të forcuar ndërkombëtarizimin e bizneseve shqiptare dhe për të zgjeruar prezencën e markës "Made in Albania" në tregjet globale – një hap i rëndësishëm drejt rritjes së eksporteve dhe njohjes ndërkombëtare të produkteve shqiptare.

Falënderojmë të gjithë partnerët, kompanitë pjesëmarrëse dhe vizitorët që kontribuan në suksesin e kësaj përvoje, si dhe komunitetin shqiptar në Greqi për mbështetjen dhe vlerësimin e vazhdueshëm. Së bashku, po e çojmë më tej cilësinë dhe traditën shqiptare në tregjet ndërkombëtare.

Një Traditë Suksesi në Promovimin e Produkteve Organike



## AIDA në MIPIM 2026 | 9–13 Mars 2026, Francë

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) mori pjesë në MIPIM 2026, një nga ngjarjet më të rëndësishme globale për sektorin e pasurive të paluajtshme dhe zhvillimin urban, që zhvillohet çdo vit në Cannes, Francë.

Gjatë pjesëmarrjes në panair, AIDA zhvilloi takime me përfaqësues të industrisë së pasurive të paluajtshme, investitorë dhe institucione ndërkombëtare, duke prezantuar potencialin e Shqipërisë si një destinacion gjithnjë e më tërheqës për investime në zhvillimin urban dhe pasuritë e paluajtshme.

Në këtë aktivitet, Shqipëria u prezantua me 83 projekte strategjike në sektorin e pasurive të paluajtshme, një pjesë e konsiderueshme e të cilave janë të përqendruara në zonat bregdetare.

Kjo platformë kontribuon në rritjen e vizibilitetit të tregut shqiptar të pasurive të paluajtshme, duke e bërë atë më të aksesueshëm për investitorët ndërkombëtarë.

9–13 Mars 2026 | Cannes, Francë



## AIDA pjesë e ITB Berlin 2026 | 3-5 Mars, Berlin

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) përmbylli me sukses pjesëmarrjen në ITB Berlin, një nga panairët më të rëndësishme ndërkombëtare të turizmit, që zhvillohet çdo vit në Berlin.

Ky aktivitet shërben si një platformë e rëndësishme për prezantimin e rolit dhe shërbimeve të AIDA-s në mbështetje të investimeve të huaja në Shqipëri. Gjatë panairit, përfaqësuesit e AIDA-s zhvilluan një sërë takimesh me aktorë të rëndësishëm të turizmit vendas dhe ndërkombëtar. Veçohen kontaktet me përfaqësues institucionalë nga vende të ndryshme, të cilët shprehën interes të drejtpërdrejtë për investime dhe gatishmëri për të forcuar komunikimin dhe bashkëpunimin në fushën e turizmit në të ardhmen.

Në standin e Shqipërisë, vizitorët dhe partnerët ndërkombëtarë u njohën me strategjinë kombëtare për turizmin, investimet në infrastrukturë dhe potencialin e vendit si një destinacion konkurrues për projekte afatgjata në mikpritje dhe zhvillim urban turistik.


Gjatë ditës së parë u zhvilluan takime me investitorë, operatorë turistikë dhe aktorë kyç të industrisë, duke kontribuar në forcimin e pozicionimit të Shqipërisë në tregun global të turizmit.



## Memorandum Bashkëpunimi mes AIDA-s dhe Dhomës së Biznesit Bullgari-Shqipëri

Në vijim të angazhimeve dhe partneriteteve të konsoliduara në kuadër të Match-Maker Albania, u zhvillua takimi ndërmjet Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA) dhe Dhomës së Biznesit Bullgari-Shqipëri (BABC), ku Drejtoresha Ekzekutive e AIDA-s, znj. Laura Saro, dhe Drejtori Ekzekutiv i BABC, z. Ervis Taluri, firmosën Memorandumin e Mirëkuptimit mes dy institucioneve.

Ky memorandum shënon një hap të rëndësishëm në zgjerimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe krijimin e një platforme të strukturuar për promovimin e mundësive të investimit dhe shkëmbimeve tregtare mes dy vendeve.



## Forumi Ekonomik Shqipëri – Kosovë

Në Tiranë u zhvillua misioni i biznesit Shqipëri-Kosovë, me iniciativën e Ambasadës së Shqipërisë dhe në bashkëpunim mes AIDA-s dhe Odës Ekonomike të Kosovës. Ky mision mbledhi një numër të konsiderueshëm kompanish nga sektorë të ndryshëm si prodhimi, ndërtimi, teknologjia, përpunimi industrial dhe industria ushqimore.

Gjatë aktivitetit u diskutua mbi rritjen e investimeve, forcimin e partneriteteve dhe adresimin e sfidave konkrete me të cilat përballen bizneset shqiptare dhe ato nga Kosova.

Një moment i rëndësishëm ishte nënshkrimi i Memorandumit të Bashkëpunimit mes Oda Ekonomike e Kosovës dhe AIDA-s, duke shënuar një hap konkret drejt lehtësimit të bashkëpunimit dhe krijimit të mundësive të reja për sipërmarrjet.

Gjatë fjalimit, znj. Laura Saro theksoi rëndësinë e intensifikimit të bashkëpunimit në turizmin malor, duke ftuar bizneset nga Kosova të kontribuojnë në zhvillimin e këtij sektori me potencial të lartë për të dy vendet.

Në panelin “Mundësitë e bashkëpunimit ekonomik Shqipëri – Kosovë”, me përfaqësues institucionale dhe të biznesit, u theksua potenciali i madh për zhvillimin e sektorëve prioritarë, si dhe nevoja për lehtësimin e procedurave dhe barrierave tregtare ndërmjet dy vendeve. Gjithashtu, u diskutuan problematikat e hasura nga bizneset nga Kosova gjatë operimit në Shqipëri dhe rëndësia e një koordinimi më të fortë institucional për të nxitur investimet.

Aktiviteti u shoqërua gjithashtu me takime B2B, të cilat krijuan lidhje të drejtpërdrejta mes kompanive dhe hapën rrugë për bashkëpunime të reja.



## Shqipëria drejt EXPO 2027 Belgrade

Shqipëria mori pjesë në Takimin e Dytë të Pjesëmarrësve Ndërkombëtarë për Expo 2027 në 10-12 Mars, Belgrade, duke confirmuar angazhimin e saj aktiv në këtë event global dhe duke ndjekur nga afër zhvillimet mbi organizimin dhe programin e ekspozitës.

Deri më tani, mbi 130 shtete kanë confirmuar pjesëmarrjen në Expo 2027, që do të zhvillohet në Belgrade nga 15 maji deri më 15 gusht 2027, nën moton “Play for Humanity”.

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) është institucioni përgjegjës për organizimin dhe koordinimin e Pavionit Kombëtar të Shqipërisë, i cili do të prezantojë prioritetet dhe potencialin e vendit në përputhje me tematikat e ekspozitës.

Delegacioni shqiptar vlerësoi temën e këtij edicioni si një mundësi për të promovuar kreativitetin, vlerat dhe potencialin e Shqipërisë, si dhe për të forcuar bashkëpunimin ndërkombëtar.

Gjatë vizitës, Ambasadori i Shqipërisë në Serbi, Bardhyl Canaj, shprehu mbështetjen e tij për përgatitjet dhe pjesëmarrjen e Shqipërisë në këtë aktivitet të rëndësishëm ndërkombëtar.



## AIDA mirëpriti Ambasadoren e Shqipërisë në Kroaci, znj. Donika Hoxha

Në kuadër të përgatitjeve për Match-Maker Albania 2026, Drejtoresha Ekzekutive e Albanian Investment Development Agency, znj. Laura Saro, priti në një takim Ambasadoren e Shqipërisë në Kroaci, znj. Donika Hoxha.

Gjatë takimit u diskutua angazhimi i Kroacisë në edicionin e dytë të forumit, si dhe organizimi i një Forumi Investimesh me fokus promovimin e Shqipërisë dhe prezantimin e mundësive konkrete të investimit për biznesin kroat.

Kroacia është tashmë pjesë e kësaj platformë bashkëpunimi, duke kontribuar në forcimin e dimensionit ndërkombëtar të Match-Maker Albania dhe në thellimin e marrëdhënieve ekonomike mes dy vendeve.



## Biznese që rriten me Mbështetjen e AIDA

### Xhevahire Design

Xhevahire Design ndan përvojën e saj si përfutuese e granteve nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA).

E specializuar në qendrisje, prerje dhe qepje të veshjeve tradicionale nga veriu në jug të Shqipërisë, Xhevahire Design ka ruajtur me përkushtim mjeshtrinë artizanale ndër vite.

Mbështetja financiare mundësoi sigurimin e një makinerie moderne qendrisjeje me program të dedikuar, e cila realizon disa procese njëkohësisht. Duke kaluar nga qendrisja tradicionale me gjergjef dore në teknologji të avancuar, biznesi ka arritur të lehtësojë ndjeshëm proceset e punës, të ulë kohëzgjatjen për përfundimin e një veshjeje dhe të rrisë efikasitetin, pa humbur autenticitetin e traditës.

Një investim që ndërthur traditën me inovacionin, duke forcuar kapacitetet prodhuese dhe konkurrueshmërinë në treg.

### Qëndistari Mira

Qëndistari Mira ndan përvojën e saj si përfutuese e granteve nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA).

Mbështetja financiare nga AIDA ka kontribuar në përmirësimin e proceseve të punës dhe në forcimin e kapaciteteve të biznesit, duke krijuar mundësi për zhvillim të mëtejshëm dhe rritje të cilësisë së produkteve.

Një histori suksesi që dëshmon se mbështetja për artizanatin dhe bizneset lokale ndihmon në zhvillimin e qëndrueshëm të tyre.

### ETNO ART

Nga pasioni për folklorin dhe etnografinë korçare, lindi "ETNO ART" – një biznes artizanal unik.

Me mbështetjen e granteve nga AIDA, u bë e mundur krijimi i faqes së saj digjitale, duke e afruar më shumë me klientët dhe tregun ndërkombëtar.

Digjitalizimi solli rritje të ndjeshme të shitjeve dhe njohjes së markës jashtë kufijve.

Nga sfidat e para, deri te sukseset e sotme – një shembull frymëzues i fuqisë së inovacionit dhe mbështetjes së duhur.

### Cibuku shpk

Nga përvoja mbi 30-vjeçare në përpunimin e bimëve mjekësore dhe aromatike, Cibuku shpk vazhdon të rritet dhe të zgjerojë praninë në tregjet ndërkombëtare.

Me mbështetjen e granteve nga AIDA, kompania investoi në një linjë të re makinerish për seleksionimin dhe standardizimin e produkteve, duke rritur cilësinë dhe kapacitetin prodhues.

Ky investim ka sjellë rritje të vlerës së produkteve dhe hapje drejt tregjeve të reja, me kërkesa konkrete nga Gjermania dhe vende të tjera ndërkombëtare.

Nga një histori e gjatë pune, drejt një faze të re zhvillimi – një shembull i qartë i ndikimit që ka mbështetja e granteve nga AIDA në rritjen e bizneseve shqiptare.

## AIDA ju informon mbi thirrjen më të re të publikuar: Green Assist via EEN

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve vijon informimin e të gjithë palëve të interesuara mbi publikimin e skemave të reja financiare, në kuadër të mbështetjes së ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme.

Në portalin "Akses në Financë" mund të gjeni thirrjen më të re të publikuar: Green Assist via EEN

Për t'u njohur me thirrjen, kushtet e pranimit, masën e financimit dhe më shumë, vizitioni platformën në linkun:

<https://aida-smefinance.gov.al/financial-schemes/green-assist-via-een>



## AIDA ju informon mbi thirrjen më të re të publikuar: GATE5.0 Matchmaking: Agri-Tech Community Building

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve vijon informimin e të gjithë palëve të interesuara mbi publikimin e skemave të reja financiare, në kuadër të mbështetjes së ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme.

Në portalin "Akses në Financë" mund të gjeni thirrjen më të re të publikuar: GATE5.0 Matchmaking: Agri-Tech Community Building

Për t'u njohur me thirrjen, kushtet e pranimit, masën e financimit dhe më shumë, vizitioni platformën në linkun:

<https://aida-smefinance.gov.al/financial-schemes/green-assist-via-een>



## AIDA ju fton të merrni pjesë në "Seafood Expo Bharat 2026"

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) informon bizneset shqiptare të produkteve ushqimore detare mbi një nga ngjarjet më të rëndësishme ndërkombëtare të sektorit. Seafood Expo Bharat 2026 është një nga panairët më të rëndësishme vjetore të produkteve detare në Azi, i organizuar nga MPEDA, institucioni përgjegjës i Qeverisë së Indisë për promovimin e eksporteve të produkteve detare.

Chennai, Indi  
1-3 Korrik 2026

Pse të merrni pjesë?

Takime të drejtpërdrejta B2B me partnerë indianë dhe ndërkombëtarë  
Mundësi për zgjerim në tregje të reja  
Prezantim i produkteve dhe shërbimeve tuaja në nivel global  
Njohje me inovacionet më të fundit në akuakulturë dhe përpunim

Programi Reverse Buyer-Seller Meet (RBSM) ofron:  
Rimbursim të biletës deri në US\$2000  
Akomodim falas  
Transport dhe asistencë gjatë qëndrimit  
Vizita në fabrika dhe ferma akuakulture



India mbetet një nga liderët globalë në eksportin e produkteve detare dhe një partner strategjik për bashkëpunim.

Ftojme bizneset e interesuara të aplikojnë dhe të përfitojnë nga kjo mundësi unike! Për më shumë informacion vizitioni faqen zyrtare të aktivitetit: [www.seafoodexpobharat.com](http://www.seafoodexpobharat.com), ose kontaktoni në adresat e email-it: [fairs@mpeda.gov.in](mailto:fairs@mpeda.gov.in); [asokkumar@mpeda.gov.in](mailto:asokkumar@mpeda.gov.in)